



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY -SUHAREKË

15.03.2019

Org. Jashine Org. Unit	Org. Number	Org. Address	Org. Phone
01	016	18559	2

Datë: 15.03.2019

Në bazë të vendimit 01-Nr-016-14946 të datës 28.02.2019 të Asamblesë Komunale dhe në bazë të procesverbalit nr. 10/2019 të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të datës 15.03.2019 komisionit përkatës shpall:

ANKAND PUBLIK Nr.02/2019

Për dhënie në shfrytëzim afatshkurtë deri 5 (pesë) vite të pronës së paluajtshme komunale:

Parcela, kadastrale, me numër **P-72116046-02785-1**, sipas certifikatës Nr.450-2019, të datës 07.02.2019 me sipërfaqe prej; **39156m²** nga sipërfaqja e përgjithshme prej; **502304m²** vendi i quajtur **"Shirok"**, zona kadastrale Suharekë, pasurisë shoqërore në emër të Kuvendit Komunal e Suharekë, me destinim sipas vendimit të Kuvendit të Komunës në Suharekë 01-Nr-16-7254 të datës 30.06.2015, është caktuar lokacion për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore.

Dëshmitë e kërkuara:

1. Kopja e dokumentit të identifikimit.
2. Çertifikata e regjistrimit të biznesit/OJQ-së (për personat juridik)
3. Dëshmi për kryerjen e obligimeve komunale (për personat fizik – Tatimi në pronë, për personat juridik – Taksa Komunale, dhe tatimi në pronë.)
4. Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (për personat juridik)

Kriteret e kërkuara;

- Oferta e kompletuar me dokumentet e kërkuara.
- Çmimi fillestar për parcelën - *minimum 1,174.00 € në vit.*
- Kompania duhet të jetë e licencuar për veprimtarinë adekuate

Vërejtje:

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve do të thotë diskualifikim.
- OE ka të drejtë të tërhiqet nga ankandi publik jo më vonë se 3 (tre) ditë para mbajtjes së ankandit publik.
- OE i cili e ofron çmimin më të lartë konsiderohet fitues i ankandit publik.
- Në bazë të vendimit të Asamblesë Komunale të datës 28.02.2019 me numër 01-Nr-016-15106 është caktuar tarifa në vlerë prej 0.50 € për m², për deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, që dorëzohen nga prodhuesit dhe krijuesit e mbeturinave ndërtimore dhe demolimi i objekteve ndërtimore.

Afati për tërheqjen e formularit të ofertave është deri më datë **12.04.2019**, zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë.

Afati i dorëzimit të ofertave bëhet me datë **15.04.2019** deri në ora **13:30** në zyren pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë, oferta duhet të jetë e protokoluar.

Hapja e ofertave bëhet me **15.04.2019** në ora **14:00** në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.

Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bën komisioni përkatës i Kuvendit të Komunës së Suharekës dhe përfituesi i rekomandohet Kryetarit të Komunës konform ligjit nr.04/L-144.

Informatat shtesë;

Nr. tel: 029 271 708

emrush.bytyci@rks-gov.net

Kryesuesi i komisionit
Emrush BYTYCI